



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.16, datë 17.07. 2009

**PËR
“MIRATIMIN E PROJEKTIT TË BASHKISË SË TIRANËS “ZHVILLIMI I TË
RINJVE NËPËRMJET FUQIZIMIT TË KOMUNITETIT NË SHQIPËRI”**

Mbështetur në nenin 10, pika 3/II të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë projektin “Zhvillimi i të rinjve nëpërmjet fuqizimit të komunitetit në Shqipëri”, me afat kohor 3 vjet, të financuar nga Banka Botërore (Fondi i Zhvillimit Social Japonez).
2. Njësia e Menaxhimit të Projekteve do të jetë struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe monitorimin e projektit.
3. Për monitorimin e zbatimit të vendimit ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Planifikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Manaxhimit të Shërbimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R